



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Altelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.542 prot., i AK, datë 22.12.2021, “Konfirmim i depozitimit të dokumenteve”, ku jemi njoftuar mbi shitjen e 80.27% të kapitalit aksionar të shoqërisë Altelecom SHA tek shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitje dhe blerje aksionesh”, palët janë:

**Pala blerëse:** 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt), është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar me objekt aktiviteti: prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike; prodhimi i makinerive dhe pajisjeve të zyrave; shitja me shumicë dhe pakicë e kompjuterave, pajisjeve periferike kompjuterike dhe softuerëve; shitje me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuara etj.

4iG Nyrt nuk ka asnjë aktivitet dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

**Pala shitëse:** Cetel Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi (Cetel), është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, e cila operon në fushën e telekomunikacionit.

**Target:** Altelecom SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë, me objekt aktiviteti: shërbimet e komunikimeve elektronike si shërbimi publik i telefonisë tokësore fikse, shërbimi publik i telefonisë tokësore të lëvizshme, transmetimi i të dhënave etj; kryerja e veprimeve financiare dhe tregtare që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me aktivitetin e saj duke përfshirë dhe zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqërive të reja etj; furnizimi, tregtimi dhe shpërndarja e pajisjeve të telekomunikacionit, të zërit , figurës, mjeteve transmetuese etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**